



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkriptit nga mbledhja e 132 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 133 dhe 134 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023, si në vijim:
 - 1.1. Shtohen në Programin Legjislativ për vitin 2023:
 - 1.1.1 Projektligji për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (ZKM), afati i miratimit në Qeveri 30.11.2023;
 - 1.1.2 Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjeve të Veçanta që kanë të bëjnë me krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga ministrat (ZKM), afati i miratimit në Qeveri 15.11.2023;
 - 1.1.3 Projektligji për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin Nr. 08/L- 067 për Inspektimet (ZKM), afati i miratimit në Qeveri 15.11.2023;
 - 1.1.4 Projektligji për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin Nr. 04/L- 202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave (ZKM), afati i miratimit në Qeveri 15.11.2023;
 - 1.1.5 Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2023;
 - 1.1.6 Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2023;
 - 1.1.7 Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2023;
 - 1.1.8 Projektligji për Armë (MPB) afati i miratimit në Qeveri 31.07.2023;
 - 1.1.9 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.05/L-015 për Letërnjoftim (MPB)), afati i miratimit në Qeveri 30.06.2023;
 - 1.1.10 Projektligji për Inspektimin në Fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit (MMPHI), afati i miratimit në Qeveri 30.11.2023;
 - 1.1.11 Projektligji për Automjete (MMPHI), afati i miratimit në Qeveri 05.12.2023;
 - 1.1.12 Projektligji për Prodhimin, Prezantimin dhe Shitjen e Duhanit dhe Produkteve të Ngjashme (MSh), afati i miratimit në Qeveri 30.06.2023.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2022.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Përfaqësimin e Institucioneve Shtetërore në Procedura Gjyqësore dhe Arbitrazh.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Analiza juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave të lëshuara në kuadër Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë.
2. Obligohen ministrinë nga pika 1. e këtij Vendimi që në pajtim me fushën e përgjegjësisë së tyre administrative të iniciojnë procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve të parapara në Analizën juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave.
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që në bashkëpunim me ministrinë përkatëse të koordinojë procesin e implementimit të analizës juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave të miratuar me këtë Vendim.
4. Pjesë e këtij Vendimi janë Shtojcat e analizës juridike për thjeshtimin, bashkimin ose eliminimin e lejeve dhe licencave të lëshuara në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës në konsultim me Presidenten e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet data 14 prill, Ditë Memoriale e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës së Fundit në Kosovë.
2. Obligohen institucionet kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafi 1. të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kompensimi financiar i njehershëm për Delegatët e legjislaturës të vitit 1990 të cilët janë certifikuar me mandatin e Deputetit në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës të datës 4 dhjetor 1999, të cilët kanë marrë pjesë në Mbledhjen e Kuvendit të Kosovës më datë 2 korrik 1990 dhe me 7 shtator 1990, si dhe kanë vazhduar të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit deri më datë 24 maj 1992.
2. Mjetet financiare të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213 në vlerë prej 287,000.00 € (dyqindtë e tetëdhjeteshtatë mijë euro) ndahen proporcionalisht sipas numrit të deputetëve konform Gazetës Zyrtare Nr. 21 të datës 3 korrik 1990.
3. Për deputetët të cilët kanë ndërruar jetë, kompensimin financiar sipas pikës 2. të këtij Vendimi, do e gëzojnë bashkëshorti/ja e deputetit/es, apo fëmiju deri në moshën 18 vjeçare, dhe nëse fëmiju është në studime deri në moshën 26 vjeçare.
4. Dokumenti në bazë të së cilit vërtetohet numri dhe identiteti i deputetëve që gëzojnë kompensimin financiar të njehershëm, sipas pikës 1. të këtij Vendimi është Gazeta Zyrtare Nr.21 e datës 3 korrik 1990.
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 23 paragrafi 2. të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Ligjit Nr. 08/L-061 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Investime për financimin e Projektit "Reagimi i Kosovës ndaj Pandemisë Covid-19 për NVM-të, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimit Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimit Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, dhe Vendimit Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 5,528,000.00 € (pesë milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë euro) për zbatimin e Masës 2.2 - Mbështetje bizneseve për qasje në financa të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Shpenzime Kapitale", nga Projekti "Financim për rikapitalizimin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive" me kod 15882, burimi i financimit "Klauzola e Investimeve", dhe ndahen në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Autorizohet Thesari i Kosovës që mjetet e ndara, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, t'i transferojë të organizata jo-buxhetore Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet përditësimi i Listës Shtetërore Strategjike për Mallra Ushtarake, duke iu referuar Listës së Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike ose për arsye të të drejtave të njeriut.
2. Kjo listë është konform pozicionit të përbashkët të këshillit të BE-së 2008/944CFSP, që përcakton mallrat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake, e përditësuar dhe që zëvendëson Listën e përbashkët Ushtarake të BE-së të miratuar nga Këshilli me 22.02.2022/ CFS (2023/C72/02).
3. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Institucionet tjera kompetente për zbatim të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/138
Datë: 12.04.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14 pika 3. të Ligjit Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet riallokimi i mjeteve në shumë prej: 3,500,000.00 €, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me kod 212, nën-programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga Projekti kapital: "Bashkëfinancimi me donatorët për skemën e granteve bazuar në performancën komunale" me kod 15525 në 14 (katërmbëdhjetë) projekte kapitale në përputhje me 14 (katërmbëdhjetë) marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Kryetarët e Komunave dhe donatorët.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga Projekti kapital "Bashkëfinancimi me donatorët për skemën e granteve bazuar në performancën komunale" me kod 15525 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
 - 2.1. "Ndërtimi i dy nënkalimeve për këmbësorë"- Komuna e Obiliqit, vlera e financimit 250,000.00 €;
 - 2.2. "Ndërtimi i parkingut në Obiliq në objektet e banesave sociale - banesa e Hades)"- Komuna e Obiliqit, vlera e financimit 60,992.00 €;
 - 2.3. "Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën "Ismajl Luma"-Komuna e Lipjanit, vlera e financimit 235.374,00 €;
 - 2.4. "Ndërtimi i shtratit të lumit dhe asfaltimi i rrugës së lumit në fshatin Gadime e Ulët"- Komuna e Lipjanit, vlera e financimit 270.000,00 €;
 - 2.5. "Ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Smallushë, Faza II"-Komuna e Lipjanit, vlera e financimit 200,000.00 €;
 - 2.6. "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vrellë të Magures dhe Gypi furnizues Gllavic - Babush-Komuna e Lipjanit, vlera e financimit 125,000.00 €;
 - 2.7. "Ndërtimi dhe zgjerimi i sheshit "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci" - Komuna e Drenasit, vlera e financimit 916.389,00 €;
 - 2.8. "Rregullimi i rrugës dhe trotuarit me kallderm rreth lumit Morava Viti - Komuna e Vitisë, vlera e financimit 120,000.00 €;
 - 2.9. "Rivitalizimi i rrugës "Hoxhë Jonuzi" dhe "Muhamet Muharremi" - Komuna e Vitisë, vlera e financimit 160,000.00 €;

- 2.10. "Rivitalizimi i hapësirave gjelbëruese rreth lumit Morava në Viti" - Komuna e Vitisë, vlera e financimit 76,237.00 €;
 - 2.11. "Ndërtimi i hapësirave publike në qendër të qytetit - Komuna e Gjakovës, vlera e financimit 736,344.00 €;
 - 2.12. "Asfaltimi i rrugës Afrim Haliti, Jashanicë" - Komuna e Klinës, vlera e financimit 49,664.00 €;
 - 2.13. "Rregullimi i shtratit të lumit Klina" - Komuna e Klinës, vlera e financimit 100,000.00€;
 - 2.14. "Ndërtimi fundërruesit për sistemin e filtrimit të ujit të pijes në Klinë" - Komuna e Klinës, vlera e financimit 200,000.00 €.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.
 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, nenit 14 pika 6 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 2,179,572.00 €, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207, për zbatimin e Programit "Masat preventive - intervenime emergjente nëpër komuna të ndryshme".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga nën-programi Mbrojtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore me kod 81500 nga kategoria e shpenzimeve kapitale, përkatësisht Projekti "Masat preventive - intervenime emergjente" me kod 12688 dhe rialokohen në projekte të reja dhe në disa ekzistuese, konform shumave të cekura:
 - 2.1. Shtëpia e familjes Fishekqiu, Prizren, në shumë prej 113,338.00 €;
 - 2.2. Shtëpia e familjes Vetimi, Prizren, në shumë prej 53,546.00 €;
 - 2.3. Shtëpia e familjes Kirajtani, Prizren, në shumë prej 59,884.00 €;
 - 2.4. Shtëpia e familjes Bërlajolli, Prizren, në shumë prej 89,832.00 €;
 - 2.5. Kompleksi Nënkalaja, Pantelija dhe Potok Mahalla, Ndërtesa në parcelën 03462-0, Prizren, në shumë prej 31,658.00 €;
 - 2.6. Shtëpia e Adem Agë Gjonit, Prizren, në shumë prej 86,721.00 €;
 - 2.7. Selamlleku i Bajram Sokolit (brenda QHPz), Prizren, në shumë prej 20,130.00 €;
 - 2.8. Shtëpia e familjes Koçbashliu (brenda QHPz), Prizren, në shumë prej 38,857.00 €;
 - 2.9. Hidroelektrana – Muzeu i Elektroekonomisë, Prizren në shumë prej 53,400.00 €;
 - 2.10. Kulla e Gjyle Kadrijaj, Rastavicë, Deçan, në shumë prej 2,959.00 €;
 - 2.11. Shkolla e Parë Shqipe, Pejë, në shumë prej 19,637.00 €;
 - 2.12. Xhamia e Trubuhovcit, Trubuhovc, Istog, në shumë prej 33,814.00 €;
 - 2.13. Mulliri i Cal Malushit, Kotradiq, Pejë, në shumë prej 8,954.00 €;
 - 2.14. Xhamia e Dranocit, Komuna e Deçanit, në shumë prej 140,000.00 €;
 - 2.15. Kulla e Tupellëve, Mitrovicë, në shumë prej 23,668.00 €;
 - 2.16. Shtëpia e Idriz Hajdarit, Tushillë, Skenderaj, në shumë prej 13,020.00 €;
 - 2.17. Kisha Katolike në Vinarç, Komuna e Mitrovicës, në shumë prej 8,203.00 €;
 - 2.18. Posta e vjetër në Mitrovicë, Mitrovicë, në shumë prej 47,254.00 €;
 - 2.19. Kulla e Hajzer Ahmet Pecit, në fshatin Zhazhë, Komuna e Zvecanit, në shumë prej 60,000.00 €;
 - 2.20. Shtëpia kullë e Vesel Godenit, Goden i Madh, Viti, në shumë prej 18,561.00 €;

- 2.21. Xhamia në Meshinë, Meshinë, Kamenicë, në shumë prej 27,359.00 €;
 - 2.22. Xhamia e Firajës, Firajë, Shtërpcë, në shumë prej 17,170.00 €;
 - 2.23. Shtëpia e Naser Thaçit, Krivenik, Hani i Elezit, në shumë prej 29,300.00 €;
 - 2.24. Oda e Haxhi Ahmetit, Remnik, Viti, në shumë prej 20,130.00 €;
 - 2.25. Shtëpia e Haxhi Ahmetit, Remnik, Viti, në shumë prej 78,934.00 €;
 - 2.26. Shtëpia e Ajet Kokaj, Kokaj, Gjilan, në shumë prej 18,659.00 €;
 - 2.27. Shtëpi banimi në Kokaj (Ilmi Rrustemi), Gjilan, në shumë prej 64,785.00 €;
 - 2.28. Shtëpia e Heset Mehmetit, Stubëll e Poshtme, Viti, në shumë prej 73,440.00 €;
 - 2.29. Çezma e Sahit Agës, Gjilan, në shumë prej 7,346.00 €;
 - 2.30. Hambari i Feriz Llashticës në Llashticë, Gjilan, në shumë prej 10,698.00 €;
 - 2.31. Shtëpia banimi në Leshtarë (Jusuf Ademi), Kamenicë, në shumë prej 64,645.00 €;
 - 2.32. Shtëpia e Rahim Sadikut (Shtëpia ku u strehua Mulla Idrizi), Gjyrishec, Kamenicë, në shumë prej 152,301.00 €;
 - 2.33. Shtëpia e Hasan Fazlisë në Koshare, Ferizaj, në shumë prej 84,524.00 €;
 - 2.34. Mulliri në Majac, Podujevë, 15,835.00 €;
 - 2.35. Vetfarmi, Prishtinë, në shumë prej 57,605.00 €;
 - 2.36. Shtëpi e vjetër – ish Stacioni Policor, Podujevë në shumë prej 27,500.00 €;
 - 2.37. Shkolla e Parë Shqipe, Prishtinë në shumë prej 17,437.00 €;
 - 2.38. Kulla e Tal Belit – Krelan, Komuna e Gjakovës, në shumë prej 83,820.00 €;
 - 2.39. Shtëpia tradicionale e Basri Kryeziut, Gjakovë, në shumë prej 38,962.00 €;
 - 2.40. Mulliri i Cermjanit, Cermjan, Komuna e Gjakovës, në shumë prej 62,304.00 €;
 - 2.41. Shtëpia e Dobrunave – Polloshka, Gjakovë, në shumë prej 91,740.00 €;
 - 2.42. Ndërtesa e QRTK-Gjakovë (në kuadër të bërthamës së Tërësisë Urbanistike “Çarshija e Madhe”), Gjakovë, në shumë prej 33,264.00 €;
 - 2.43. Taphanja, Gjakovë, në shumë prej 43,560.00 €;
 - 2.44. Kulla e Shain Dulës, Gjakovë, në shumë prej 38,962.00 €;
 - 2.45. Dyqani i Musa Goranit (Kodi buxhetor 15978), Pejë në shumë prej 2,199.00 €;
 - 2.46. Xhamia në Dunav (Kodi buxhetor 15991), në shumë prej 2,001.00 €;
 - 2.47. Xhamia në Carrabreg (Kodi buxhetor 15995), në shumë prej 25,419.00 €;
 - 2.48. Mulliri i Islam Zenelit në Pagarushë, Malishevë (Kodi buxhetor 15987) në shumë prej 3,675.00 €;
 - 2.49. Rindërtimi i Mullirit të Mehmet Alisë, Marali-Shkozë, Komuna e Malishevës (Kodi buxhetor 15726) në shumë prej 1,000.00 €;
 - 2.50. Mulliri dhe Hambari i Familjes Jonuzaj në fshatin Senik të Malishevës (Kodi buxhetor 15727), në shumë prej 22,374.00 €;
 - 2.51. Kulla e Tafollit, Çadrak-Suharekë (Kodi buxhetor 15729), në shumë prej 3,045.00 €;
 - 2.52. Shtëpia Mahmut Agë Gjinollit, Vushtrri (Kodi buxhetor 14233), në shumë prej 36,143.00 €.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të Promovimit të Republikës së Kosovës, ndahen mjete financiare në shumë prej 20,000 (njëzetë mijë euro) për Fondacionin Cardinal Domenico Bartolucci, si financim i pjesshëm i koncertit orkestral, që do të mbahet me 21 qershor 2023 në Vatikan.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nën-programi për Promovim të Vendit dhe barten në xhirollogarinë e Fondacionit Cardinal Domenico Bartolucci.
3. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1, nenit 19 paragrafi 3. dhe nenit 43 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar dhe plotësuar me nenet 3 dhe 22 të Ligjit Nr. 04/L-111, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Hekurudhat e Kosovës - Trainkos" Sh. A. (tutje "Ndërmarrja"), përkatësisht kryesuesi dhe anëtari i vetëm i Bordit të Drejtorëve, z. Nol Dedaj.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Ndërmarrjes me këtë përbërje:
 - 2.1. Riza Spanca, kryesues;
 - 2.2. Astrit Mehaj, anëtar;
 - 2.3. Hasan Preteni, anëtar; dhe
 - 2.4. Shaban Neziri, anëtar.
3. Obligohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të veprojë sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të Ndërmarrjes.
4. Mandati i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë (6) muaj dhe nuk mund të vazhdohet.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Neni 19.3 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike krijon bazë për Qeverinë të shkarkojë anëtarët e Bordit të Drejtorëve për të cilat ka "arsye për të besuar se kanë shkelur detyrat fiduciare". Termi *detyrë fiduciare*, i huazuar nga anglishtja, përkufizohet si detyrë për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj. Sipas nenit 17.2 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, "kryesuesi është përgjegjës për udhëheqjen e Bordit, duke siguruar efikasitetin e tij në të gjitha aspektet e rolit të tij dhe vendosjen e agjendës së tij".

Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes është emëruar me Vendimin e Qeverisë Nr. 03/92 të datës 10 gusht 2022. Bordi është vonuar për t'i kërkuar menaxhmentit përgjegjësi për rënien e vazhdueshme të performancës dhe shkeljet e evidentuara nga raportet e Zyrës Kombëtare të


Auditimit për vitet 2016-2021 dhe nuk ka marrë masa për uljen e domosdoshme të shpenzimeve në raport me të hyrat e Ndërmarrjes.

Tre anëtarë të Bordit kanë dhënë dorëheqje, duke njoftuar aksionarin se e kanë të pamundur përmbushjen e detyrave fiduciare për shkak të mospajtimeve me kryesuesin për organizimin e punës së bordit dhe pamundësimin të marrjes së vendimeve të domosdoshme dhe urgjente për Ndërmarrjen. Dy anëtarë të tjerë kanë dhënë dorëheqje për shkaqe personale. Kryesuesi ka ngelur i vetëm si anëtar i bordit.

Këto rrethana japin arsye për të besuar se kryesuesi i Bordit ka shkelur detyrat fiduciare dhe nuk ka përmbushur përgjegjësitë e parapara me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative. Rrjedhimisht, duke u mbështetur në nenin 19.3 të LNP-së, Qeveria vendosi të shkarkojë Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes, përkatësisht kryesuesin si anëtarin e vetëm të mbetur.

Tutje, sipas autorizimit nga neni 43 i LNP-së, Qeveria vendosi të emërojë një Bord të Përkohshëm të Drejtorëve, për të shërbyer deri në emërimin e Bordit me mandat të rregullt, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë